# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-468287**
VERSIONI 9

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Hyseni aludoi për lidhje të Klodiana Lalës me agjentë serbë, deputetja e PS: SPAK ta trajtojë me përparë si kallëzimin e gazetares! Mbrojtja e tyre kusht për demokracinë - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/hyseni-aludoi-per-lidhje-te-klodiana-lales-me-agjente-serbe-deputetja-e-ps-spaku-ta-trajtoje-me-perparesi-kallezimin-mbrojtja-e-gazetareve-kusht-per-demokracine` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 09:48:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 09:43:47 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `659a9fbcf7f46d578404e3bfa0cdef5086f3975e1bc30cdad421cea558112616` |
| TEKSTI | `04873e7e02dba4dcd90d693e54a2e7e20635427da092bce0c30420e86b7c17ba` |
| PAMJA | `7ea86c054eeef67e2406f19b2f528402e58d8bf6d58790b8068561daf819c164` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `289920c761709d019c5c4053681a86681bf547bf1385e40da707fca70a3e5e91` |
| E MËPARSHMJA | `3ee8674a79107493eaf3e67a50efe0779eac0d307f3a8b6b75e1a28aa70d88a5` |
| RRËNJA MERKLE | `96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/289920c761709d019c5c4053681a86681bf547bf1385e40da707fca70a3e5e91`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kronikë

# Hyseni aludoi për lidhje të Klodiana Lalës me agjentë serbë, deputetja e PS: SPAK ta trajtojë me përparësi kallëzimin e gazetares! Mbrojtja e tyre kusht për demokracinë

*Deputetja e Partisë Socialiste, Iris Luarasi, ka reaguar një ditë pasi ish-drejtoresha e Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni, pretendoi se gazetarja Klodiana Lala kishte lidhje me agjentë serbë.*

■ Hyseni aludoi për lidhje të saj me agjentë serbë, Klodiana Lala: Do dorëzoj kallëzim penal ndaj ish-kreut të SHISH-it





*Vlora Hyseni dhe Klodiana Lala*

Redaksia
25 Shtator, 11:36 | **Përditesimi: 25 Shtator, 11:55**

Share Tweet

Deputetja e Partisë Socialiste, Iris Luarasi, ka reaguar një ditë pasi ish-drejtoresha e Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni, pretendoi se gazetarja Klodiana Lala kishte lidhje me agjentë serbë. Hyseni i bëri aludimet e saj, pikërisht pasi u pyet nga Lala për materialet e klasifikuara që kishin përfunduar në duart e Ergys Agasit.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, Luarasi e ka dënuar sjelljen ndaj gazetares dhe i ka bërë thirrje SPAK-ut si dhe institucioneve të tjera përgjegjëse që të marrin masa të menjëhershme për trajtimin e kallëzimit dhe garantimin e mbrojtjes së saj.

> *"Deklarata e ish-drejtueses së SHISH-it ndaj Klodiana Lala në hyrje të GJKKO-së është e papranueshme. Një gazetare po bënte një pyetje me interes publik. Në vend të përgjigjes mori insinuata që dëmtojnë reputacionin, integritetin profesional dhe sigurinë e saj personale.*


LEXO EDHE:
**'Edi Rama duhet të arrestohet', Blushi: Përgjegjësia për SHISH nuk mbaron te drejtorët**

*Si zëvendëskryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Median, i bëj thirrje SPAK-ut që*

> *ta trajtojë me seriozitet dhe me përparësi kallëzimin e gazetares. I bëj thirrje gjithashtu institucioneve përgjegjëse që të garantojnë mbrojtjen e saj.*
>
> *Pyetjet e gazetarëve duhet të marrin përgjigje, jo kërcënime. Mbrojtja e gazetarëve është detyrim i shtetit dhe kusht për demokracinë. Gazetarët që bëjnë pyetje nuk janë armiq", shkroi në rrjete sociale Lala.*

Për Shqiptarja.com gazetarja Klodiana Lala tha se do të bënte këtë të premte një kallëzim penal ndaj ish-kreut të SHISH, teksa theksoi se 'në këtë histori nuk ka asnjë të vërtetë'.

> *"Ajo që Hyseni bëri ndaj meje është shantazh për shkak të detyrës dhe sepse kam raportuar për çështjen e saj. Nga ana tjetër është të dhe një mënyrë për të shantazhuar dhe të tjerë, përfaqësues të medias apo politikanë, që të mos flasin për rastin e saj", tha Lala.*

Iris Luarasi
about an hour ago · 🌐

Deklarata e ish-drejtueses së SHISH-it ndaj Klodiana Lala në hyrje të GjKKO-së është e papranueshme. Një gazetare po bënte një pyetje me interes publik. Në vend të përgjigjes mori insinuata që dëmtojnë reputacionin, integritetin profesional dhe sigurinë e saj personale.
Si zëvendëskryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Median, i bëj thirrje SPAK-ut që ta trajtojë me seriozitet dhe me përparësi kallëzimin e gazetares. I bëj thirrje gjithashtu institucioneve përgjegjëse që të garantojnë mbrojtjen e saj.
Pyetjet e gazetarëve duhet të marrin përgjigje, jo kërcënime. Mbrojtja e gazetarëve është detyrim i shtetit dhe kusht për demokracinë. Gazetarët që bëjnë pyetje nuk janë armiq. #LiriaeShtypit #PressFreedom #SafeJournalists #StopIntimidimitTëGazetarëve See less

Foto: Postimi i Iris Luarasit

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: iris luarasi | hetimet per grupin e agasit | vlora hyseni | Klodiana Lala | SHISH

Sa e vlerësoni këtë artikull? ☆☆☆☆☆ 3.5 / 5 (4 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente** Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 22 Shtator, 16:08
**Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?**

Po | Jo | Disi

## Lajme të tjera




**Arresti i ish-kreut të SHISH, të hënën mblidhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare! PD: Socialistët mbrojnë Hysenin! PS: Përgjegjësia personale**
25 Shtator, 14:39



**Eksperti rrëzon alibinë e Hysenit për Agasin: Kreu i SHISH s'mban kontakte direkte me informatorë, ja si mund ta verifikojë SPAK! Audit për informacionet e rrjedhura**
25 Shtator, 14:06



**Mediat: SPAK do marrë në pyetje dhe kreun e sapo komanduar të SHISH dhe drejtorin e operacioneve! 'U kapën duke fshirë serverët e SHISH?!'**
25 Shtator, 13:43



**Begaj mbledh të hënën Këshillin e Sigurisë Kombëtare, Bardhi: Spektakël institucional! Të japë llogari për**



**Debat për Vlora Hysenin në Komision/ Zhupa: Krerët e institucioneve në shërbim të krimit! Malaj: Përgjegjësia penale**




**Thoma Gëllçi: Kush e çoi Vlora Hysenin në krye të SHISH-it?**

Thoma Gëllçi

emërimin e Vlora Hysenit në krye të SHISH
25 Shtator, 13:19

është individuale (VIDEO)
25 Shtator, 12:30

25 Shtator, 09:58



Ish-kreu i SHISH nën akuzë nga SPAK se ndihmoi Agasin me të dhëna sekrete, Muçi për Report Tv: Rama të mbajë përgjegjësi politike, shteti ka rënë
25 Shtator, 09:49



Mero Baze: Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitet
Mero Baze
25 Shtator, 06:57



Spahiu: Gjermania, SHBA, Franca dhe Spanja asnjëherë s'kanë pasur grua në krye të Shërbimit Sekret
24 Shtator, 22:56



Sandër Lleshaj: Shërbimi ynë jo inteligjent
Sandër Lleshaj
24 Shtator, 22:46



Ish-kreu i SHISH në 'arrest shtëpie'/ Ish-prokurori: E mjerueshme që institucioni më i rëndësishëm i sigurisë kombëtare është në këtë gjendje! Prençi: Duhej masë më e fortë sigurie për Hysenin
24 Shtator, 22:33



Spahiu: Vlora Hyseni si kryespiune grua nuk ka tradhtuar shtëpinë, por Shqipërinë
24 Shtator, 21:48



[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.